



Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës
Komora Fizioterapeuta Kosova
Kosovo Chamber of Physiotherapists

NR.I PROTOKOLIT 609

NR.I FAQEVE TË BASHKANGJITURA 22

DATA 22/12/2023 PK 23

PRISHTINË - KOSOVË

Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës/ Komora Fizioterapeuta Kosova
Kosovo Chamber of Physiotherapists

STATUTI

I

ODËS SË FIZIOTERAPEUTËVE TË KOSOVËS

Prishtinë, 2024

Adresa: Kompleksi i Q.K.U.K, Klinika e Mjekësisë Fizikale me Rehabilitim, Kati i I-rë, RKS-10000.
Address: UCKK Complex, Physical Medicine Clinic with Rehabilitation, 1st Floor, RKS-10000.
Tel +383(0) 45 460 551; e-mail info@oftk-ks.org; web : www.oftk-ks.org

Oda e
Fizioterapeutëve
të Kosovës





Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës/ Komora Fizioterapeuta Kosova

Kosovo Chamber of Physiotherapists

Kuvendi i Odës së Fizioterapeutëve të Kosovës në mbështetje të Nenit 47 paragrafi 1, Neni 48, Neni 49, Neni 50 i LIGJI Nr. 04/L-150 PËR ODAT E PROFESIONISTËVE SHËNDETËSOR në mbledhjen e mbajtur me datë 22.12.2023 Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës përmes votimit të kualifikuar të anëtarëve të Kuvendit të OFTK-së miraton plotësim ndryshimin e

STATUTIN E ODËS SË FIZIOTERAPEUTËVE TË KOSOVËS

(Teksti i spastruar me plotësime dhe ndryshime të miratuara sipas Vendimit të Kuvendit të OFTK-së nr.600, dt.22.12.2023)

I.DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës (në tekstin e mëtejme Oda), është organizatë e pavarur profesionale e fizioterapeutëve që ushtron veprimtari profesionale fizioterapeutike në Republikën e Kosovës.

Neni 2

Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës është organizatë e pavarur e cila mbron dhe prezanton interesat profesionale të anëtarëve të saj, siguron standardet e larta të kodit të etikës dhe deontologjisë mjekësore, promovon dhe mbron veprimtarinë e profesionistëve shëndetësorë në institucionet shëndetësore publike dhe private. Oda e fizioterapeutëve të Kosovës siguron edukimin e vazhdueshëm profesional me qëllim të ofrimit sa më cilësor të shërbimeve shëndetësore dhe shërbimeve tjera që kanë të bëjnë me kujdesin shëndetësor.

Neni 3

Me këtë Statut të Odës së Fizioterapeutëve të Kosovës rregullohet emërtimi, selia dhe organizimi i brendshëm i odës, anëtarësia në odë, kompetencat e odës, organizimi dhe funksionimi i odës, mbajtja e regjistrit të anëtarëve të odës, organet e odës, mënyra e zgjedhjes dhe revokimit të anëtarëve të odës, përbërja dhe kompetencat e organeve të odës, përgjegjësia disiplinore e anëtarëve të odës, procedurat para Këshillit Etik dhe Gjyqit të Nderit të Odës, shqiptimi i masave disiplinore, burimet e financimit të odës dhe çështjet e tjera me rendësi për punë dhe funksionimin të odës.

Neni 4

1.Oda ka statusin e personit juridik me të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e parapara me Ligjin nr.04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësor, aktet nënligjore dhe këtë Statut.

2. Oda do veprojë në emër të vetë dhe do të jetë përgjegjëse për detyrimet e veta me të gjitha pasuritë e tyre.

Neni 5

1.Emërtimi i OFTK-së është: Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës (OFTK).





Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës/ Komora Fizioterapeuta Kosova

Kosovo Chamber of Physiotherapists

2. Selia e Odës është në Prishtinë.

Neni 6

Odën e përfaqëson dhe reprezenton Kryetari i Odës dhe në rast mungese të Kryetarit, odën e përfaqëson dhe reprezenton njëri nga zëvendës kryetarët e Odës

Neni 7

Oda e ka vulën e vet, përcaktimi i formës, përmbajtjes së vulës, procedura për mënyrën e punimit, përdorimit, ruajtjes si dhe përgjegjësia për përdorimin e vulës bëhet në pajtim me Ligjin Nr.03/L-54 për Vula në Institucionet e Republikës së Kosovës dhe aktet nënligjore të tije.

Neni 8

- 1.Emblema e Shoqatës së Fizioterapeutëve të Kosovës është simbol zyrtarë i Odës së Fizioterapeutëve të Kosovës.
- 2.Simboli i Odës së Fizioterapeutëve të Kosovës gëzon mbrojtje ligjore.

II. ANËTARËSIMI NË ODË

Neni 9

- 1.Anëtarësimi në Odë është obligative për të gjithë fizioterapeutët, të cilët ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Republikën e Kosovës.
- 2.Anëtarësimi në odë është obligative është për të gjithë fizioterapeutët të cilët ushtrojnë veprimtarinë e tyre në kushte të mbrojtjes sociale, institucione të tjera të organeve shtetërore, në fakultete, gjegjësisht në shkolla profesionale, në ambulanca të mjekësisë së punës si dhe në të gjitha rrethanat tjera ku ushtrohet veprimtaria shëndetësore në përputhje me ligjet në fuqi.
3. Anëtarësimi, Ri anëtarësimi, Licencimi dhe Ri-licencimi në OFTK përcaktohet me akt të veçantë të miratuar nga Kuvendi i OFTK-së.

Neni 10

1. Statusi i anëtarit të Odës fitohet me regjistrimin në regjistrin qendror të Odës së Fizioterapeutëve të Kosovës (OFTK).
2. Organet kompetente të Odës së Fizioterapeutëve në afat prej 15 ditësh nga dita e paraqitjes së kërkesës nga profesionistët shëndetësor me vendim lejojnë regjistrimin në regjistrin e profesionistit shëndetësor.





Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës/ Komora Fizioterapeuta Kosova
Kosovo Chamber of Physiotherapists

3. Ndaj vendimit nga paragrafi 2 i këtij Neni mund të ushtrohet ankesa organit kompetent në afat prej 15 ditësh nga dita e nxjerrjes së vendimit.

Neni 11

1. Në realizimin e kompetencave dhe detyrave të odës anëtarët e odës kanë këto të drejta:
- 1.1. Të ushtrojnë veprimtarinë për të cilën janë licencuar
 - 1.2. Të zgjedhin dhe të zgjidhen në organet e OFTK-së ;
 - 1.3. Të informohen për të gjitha çështjet e punës dhe afarizmit të odës;
 - 1.4. Që në mënyrë të drejtpërdrejt apo nëpërmjet përfaqësuesve të vetë të japin propozime dhe shprehin mendimin e tyre për mbrojtjen e interesave dhe integritetit personal dhe të përgjithshëm në ushtrimin e veprimtarisë mjekësore;
 - 1.5. Të shfrytëzojnë, ndihmën materiale të odës nga fondi i veçantë i solidaritetit, nën kushtet dhe procedurat e parapara me akte të veçanta të odës;
 - 1.6. Të shfrytëzojnë të drejta të tjera të parapara me akte të veçanta të odës.

Neni 12

1. Anëtarët e odës kanë këto obligime dhe përgjegjësi:
- 1.1. Të respektojnë, Legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës, Statutin e Odës, Kodin e Etikës Profesionale dhe aktet tjera normative të aprovuara në Kuvendin e Odës së Fizioterapeutëve të Kosovës (OFTK).
 - 1.2. Që në mënyrë të rregullt të paguajnë anëtarësinë e odës;
 - 1.3. Të marrin pjesë rregullisht dhe ti kryejnë obligimet në organet e odës në të cilat janë zgjedhur;
 - 1.4. Të respektojnë standardet dhe normat profesionale të bazuara në shkencë dhe evidencë për të gjitha shërbimet shëndetësore fizioterapeutike në mënyrë permanente të përfshihen në edukimin e vazhdueshëm profesional;
 - 1.5. Anëtarë i OFTK-së i cili ofron shërbime shëndetësore fizioterapeutike gjatë fushatave reklamuese, marketingut dhe promovimit, obligohet t'i përmbahet rregullave të përcaktuara me akt të veçantë të OFTK-së. Mosrespektimi i tyre paraqet shkelje të rëndë të etikes profesionale.
 - 1.6. Të përmbushin obligimet dhe përgjegjësit e tjera të parapara me akte të veçanta të Odës;

Neni 13

1. Anëtarëve të Odës ju ndërpritet anëtarësimi në odë në këto raste:
- 1.1. Me revokimin e përhershëm të licencës;
 - 1.2. Në bazë të kërkesës të anëtarit të Odës nga dita e marrjes së vendimit nga organi kompetent i odës për çregjistrim nga regjistri i anëtarëve të odës;
 - 1.3. Në rast të humbjes së zotësisë së veprimit në bazë të vendimit të plotfuqishëm gjyqësor
 - 1.4. Në rast të mospagesës së anëtarësisë në vazhdimësi gjashtë muaj;





Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës/ Komora Fizioterapeuta Kosova
Kosovo Chamber of Physiotherapists

1.5. Në rast të vdekjes së anëtarit të Odës.

Neni 14

Anëtarit të Odës që i është ndërpre anëtarësia është i obliguar që në afat prej 7 ditësh t'i dorëzoj odës kartelën e anëtarësimit dhe vulën personale.

Neni 15

Anëtarët e nderit

1. Këshilli Drejtues mund t'i propozojnë Kuvendit të OFTK-së titullin për Kryetar Nderi dhe Anëtarë Nderi për merita të jashtëzakonshme në fizioterapi
2. Kryetar dhe Anëtarë të Nderit mund të marrin pjesë në punën e Kuvendit të OFTK-së, mund të diskutojnë, por nuk mund të votojnë.
3. Titujt Kryetar nderi, anëtarë nderi, dekoratat, mirënjohjet dhe shpërblimet rregullohen me akt të veçantë të OFTK-së

III. KOMPETENCAT E ODËS

Neni 16

Kompetencat – Veprimtaritë publike të odës

Kompetencat publike të odës janë:

1. Miraton Kodin e Etikës Profesionale (Kodin e Etikës)
2. Regjistron dhe mirëmban regjistrin e fizioterapeutëve të anëtarësuar në OFTK;
3. Lëshimi i licencave, ri-licencimi dhe revokimi i tyre;
4. Zbatimi i mbikëqyrjes profesionale me angazhimin e ekspertëve të lëmive përkatëse;
5. Bashkëpunimi me organet shtetërore dhe lokale që adresojnë çështjet e shëndetësisë dhe bashkëpunimit me shoqatat e tjera profesionale në vend dhe jashtë vendit;
6. Ushtron mbikëqyrjen profesionale dhe ligjore mbi punën e profesionistëve shëndetësor;
7. Planifikon, zbaton edukimin e vazhdueshëm profesional;
8. Ndërmjetëson në kontestet në mes anëtarëve të odës dhe shfrytëzuesve të shërbimeve shëndetësore;
9. Organizon gjyqet e nderit në lidhje me përcaktimin e shkeljeve dhe obligimeve profesionale të anëtarëve të odës dhe shqipton masa disiplinore;
10. Cakton lartësinë e anëtarësisë të anëtarëve të odave;
11. Cakton lartësinë e taksës për licencim, ri-licencim, dhe lejeve të tjera për ushtrimin e veprimtarisë profesionale në bazë të autorizimeve ligjore;
12. Lëshon kartelat e identifikimit dhe numrat identifikues për anëtarët e odës;





Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës/ Komora Fizioterapeuta Kosova

Kosovo Chamber of Physiotherapists

13. Me kërkesën e anëtarëve të odës, lëshon certifikata, vërtetime dhe dokumente tjera në bazë të evidencës zyrtare të odës.

Neni 17

Përgjegjësit publike organet e odës i ushtrojnë sipas procedurës së paraparë me Ligjin mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Neni 18

Kompetencat e tjera të odës

Përveç autorizimeve publike nga Neni 9 i LIGJIT Nr.04/L-150 për Oda e Profesionistëve Shëndetësor, dhe Nenin 16 të këtij Statuti, OFTK ushtron edhe këto punë:

1. Përfaqëson dhe mbron interesat profesionale të anëtarëve të odës në ushtrimin e profesionit;
2. Kujdeset për ruajtjen e autoritetit të anëtarëve të odës në ushtrimin e punëve profesionale në pajtim me etikën profesionale;
3. Mban evidencën e anëtarëve të odës që ushtrojnë veprimtarinë publike, private dhe publiko-private shëndetësore të cilat janë të regjistruar në regjistrin e organit kompetent në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi.
4. Bashkëpunimi me organet shtetërore dhe lokale që adresojnë çështjet e shëndetësisë dhe bashkëpunimi me shoqatat e tjera profesionale në vend dhe jashtë vendit;
5. Bashkëpunimi në përgaditjen e ligjeve, dokumenteve si dhe akteve tjera nënligjore në sektorin e shëndetësisë si dhe mbikëqyrja e zbatimit të tyre;
6. Propozimi dhe iniciimi i procedurave për nxjerrjen e akteve të përgjithshme dhe të veçanta në përputhje me Ligjin, Statutin dhe aktet e tjera të Odës;
7. Përcaktimi i çmimorës së shërbimeve shëndetësore dhe shërbimeve fizioterapeutike në bashkëpunim me Fondin e Sigurimeve Shëndetësore dhe shfrytëzuesit e shërbimeve shëndetësore;
8. Përcaktimi i çmimeve të produkteve mjekësore në bashkëpunim me institucionet e tjera përgjegjëse;
9. Bashkëpunimi në përpilimin e plan-programeve për edukim të vazhdueshëm profesional për të gjithë profesionistët shëndetësorë;
10. Zbatimi i aktiviteteve shkencore dhe hulumtuese në përputhje me detyrat dhe përgjegjësitë e odës;
11. Përfaqësimi i interesave profesionale dhe sociale të profesionistëve shëndetësor dhe bashkëpunëtorëve tjerë;
12. Konsultimi, ofrimi i ndihmës dhe përfaqësimi i interesave të anëtarëve në fushën e legjislacionit si dhe lëmive tjera që ndërlidhjen e fushën e shëndetësisë;
13. Pjesëmarrja në vendimmarrje në lidhjen e kontratave me Fondin për Sigurime Shëndetësore;
14. Krijimi dhe menaxhimi i fondit të odës;





Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës/ Komora Fizioterapeuta Kosova

Kosovo Chamber of Physiotherapists

15. Bashkëpunon në parandalimin e veprimtarisë shëndetësore ilegale;
16. Përgatitja dhe lëshimi i formave dhe dokumenteve i revistave, librave dhe publikimeve tjera;
17. Promovimi i bashkëpunimit ndërmjet anëtarëve të odës;
18. Promovimi dhe zbatimi i aktiviteteve kulturore dhe shoqërore të anëtarëve, organizimi i ngjarjeve kulturore, sportive dhe ngjarje të tjera sociale;
19. Emërimi i përfaqësuesve të odës në marrëveshje me institucionet e të gjitha niveleve të kujdesit shëndetësor;
20. Zbatimi i aktiviteteve tjera në përputhje me ligjin, këtë statut dhe aktet tjera të përgjithshme të odës.

IV. ORGNET E ODËS

Neni 19

1. Organet e Odës janë:

- 1.1. Kuvendi
- 1.2. Kryetari i Odës;
- 1.3. Këshilli Drejtues;
- 1.4. Këshilli Mbikëqyrës i Odës;
- 1.5. Këshilli Etik;
- 1.6. Gjyqi i Nderit;
- 1.7. Prokurori i Odës;
- 1.8. Komisionet e përhershme të Odës.

2. Mandati i anëtarëve të organeve të Odës është 4 vite.

3. Anëtarët e Kuvendit të Odës mund të zgjidhen sërish pas skadimit të mandatit edhe për një mandat (4) vjeçar.

4. Kompensimi i shpenzimeve materiale të odës si dhe kompensimi për punë të anëtarëve të odës përcaktohet me akt të veçantë normativ të odës të aprovuar nga Kuvendi i Odës.

5. Mënyra e zgjedhjes dhe revokimit të anëtarëve të organeve të odës përcaktohet me Rregullore për Zgjedhjen e Organeve të OFTK-së.

Neni 20

Kuvendi i Odës

1. Kuvendi është organi më i lartë i Odës i cili ushtron të drejtat dhe përgjegjësit të parapara me Ligj dhe këtë statut

2. Mënyra e zgjedhjes dhe revokimit të anëtarëve të Kuvendit të odës përcaktohet me Rregulloren mbi Zgjedhjen e Organeve të OFTK-së.

3. Anëtarët e Kuvendit të OFTK-së zgjidhen me votim të drejtpërdrejt në njësit zgjedhore të përcaktuara nga organi zgjedhor i emëruar në bazë të Rregullores mbi Zgjedhjen e Organeve të OFTK-së

Adresa: Kompleksi i Q.K.U.K, Klinika e Mjekësisë Fizikale me Rehabilitim, Kati i I-rë, RKS-10000.

Address: UCCK Complex, Physical Medicine Clinic with Rehabilitation, 1st Floor, RKS-10000.

Tel +383(0) 45 460 551; e-mail info@oftk-ks.org; web : www.oftk-ks.org

Oda e
Fizioterapeutëve
të Kosovës





Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës/ Komora Fizioterapeuta Kosova
Kosovo Chamber of Physiotherapists

Neni 21
Kompetencat e Kuvendit

Kuvendi është organi më i lartë i Odës, i cili ka këto përgjegjësi dhe autorizime:

1. Miraton, ndryshon dhe plotëson statutin dhe aktet e tjera normative;
2. Miraton Kodin e Etikes profesionale;
3. Miraton programin e punës së odës;
4. Miraton rregulloren e punës së odës;
5. Zgjedh dhe shkarkon Kryetarin e Odës;
6. Miraton dhe shkarkon anëtarët e Këshillit Drejtues të Odës;
7. Zgjedh dhe shkarkon Kryetarin, zv. Kryetarin dhe anëtarët e Këshillit Etik;
8. Zgjedh dhe shkarkon Kryetarin dhe anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës;
9. Zgjedh dhe shkarkon Kryetarin dhe anëtarët e Gjyqit të Nderit;
10. Zgjedh dhe shkarkon Prokurorin e Odës;
11. Zgjedh dhe shkarkon Kryetarin dhe anëtarët e Komisioneve të përhershme të Odës;
12. Përcakton lartësinë e anëtarësisë për anëtarët e odës;
13. Përcakton lartësinë e kompensimit (taksës) për anëtarët e odës, taksën për licencim dhe ri licencim si dhe lartësinë e taksës për lëshimin e certifikatave, vërtetime dhe dokumente tjera për të cilat oda mban evidencë zyrtare;
14. Përcakton lartësinë e kompensimit për regjistrimin në regjistrin e anëtarëve të odës;
15. Vendosi për lartësinë e mjeteve të ndara për fondin e odës për ndihmë reciproke të anëtarëve të odës.
16. Shqyrton dhe miraton raportet e punës së organeve të odës;
17. Miraton raportin vjetor të odës;
18. Miraton raportin financiar dhe llogarinë përfundimtare të odës;
19. Miraton raportin mbi punën e këshillit drejtues të odës;
20. Merr vendim për shkarkim të Kuvendit të Odës dhe shpall zgjedhjet e parakohshme;
21. Vendosi për anëtarësim të odës në organizatat ndërkombëtare si motra, merr vendime për ndarjen e mirënjohjeve dhe shpërblimeve të odës;
22. Shqyrton dhe merr qëndrime parimore për çështjet me rendësi për punën e odës

Neni 22

1. Mandati i anëtarit/es të Kuvendit të Odës përfundon para kohe kur:
 - 1.1. Nuk jep betimin brenda dy takimeve të njëpasnjëshme të Kuvendit të Odës pas certifikimit të rezultatit zgjedhorë,





Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës/ Komora Fizioterapeuta Kosova
Kosovo Chamber of Physiotherapists

- 1.2. Jep dorëheqje,
- 1.3. Përfundon mandati i Kuvendit të Odës,
- 1.4. Me humbjen e statusit të anëtarit të Odës,
- 1.5. Mungon në dy takime radhazi pa arsye dhe pa njoftim paraprak të Kryetarit të Odës,
- 1.6. Dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepër penale me një ose më shumë vjet burgim,
- 1.7. Me rastin e vdekjes së anëtarit/es,
- 1.8. Nëse organet etike me vendim të formës së prerë tërheqin licencën e anëtarit për së paku 5 (pesë) vite,
- 1.9. Nëse për përfundimin e mandatit të tij votojnë shumica e anëtarëve të njësisë zgjedhore të cilën përfaqëson anëtari/ja. Procedura dhe iniciativa për realizimin e këtij votimi përcaktohen sipas Rregullores për Zgjedhjen e Organeve të OFTK-së,
- 1.10. Me rastin e përfundimit të mandatit të anëtarit të Kuvendit para kohe, anëtarit i pushon secili funksion të cilin e ushtron brenda organeve të cilat zgjedhën nga Kuvendi,
- 1.11. Procedura e zëvendësimit të anëtarëve të OFTK-së të cilët përfundojnë mandatin para kohe, përcaktohet me Rregulloren për Zgjedhjen e Organeve të OFTK-së.

Neni 23

1. Mbledhjet e Kuvendit të Odës janë publike dhe mund të mbahen nëse janë prezent më shumë se gjysma e anëtarëve, nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Kuvendit të Odës.
2. Mbledhjen e Kuvendit të Odës e udhëheq Kryetari i Odës.
3. Votimi për pikat e rendit të ditës është i hapur përveç në raste kur Kuvendi vendos ndryshe
4. Statuti i Odës si dhe ndryshimet dhe plotësimet e tij miratohen me votimin e 2/3 të anëtarëve nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Odës.
5. Vendimet e tjera kuvendi i merr me shumicën e thjeshtë të anëtarëve prezent.

Neni 24

Me rregulloren mbi punën e Kuvendit të Odës më për së afërmi përcaktohen mënyra e konvokimit të mbledhjeve të Kuvendit, e udhëheqjes së mbledhjes së Kuvendit dhe mënyra e marrjes së vendimeve, dhe çështje tjera procedurale dhe teknike për mbarëvajtjen e mbledhjeve të Kuvendit.

Neni 25

1. Me propozimi të Këshillit Drejtues, Këshillit Mbikëqyrës, ose ¼ e anëtarëve të Odës. Kryetari i OFTK-së është i obliguar të thërras mbledhjen e jashtëzakonshme të Odës në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të propozimit.
2. Në rast të pamundësisë së arsyeshme të Kryetarit mbledhjen e thërret njeri nga Zëvendës Kryetarët.





Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës/ Komora Fizioterapeuta Kosova

Kosovo Chamber of Physiotherapists

3. Në rast se mbledhja e Kuvendit nuk caktohet në afatin e përcaktuar, mbledhjen e Kuvendit mund ta thërras Këshilli Drejtues.

4. Propozimi nga paragrafi 1 i këtij neni duhet të formulohet me shkrim së bashku me materialin e rendit të ditës.

Neni 26

Kryetari i Odës

Detyrat dhe përgjegjësitë e Kryetarit të Odës:

1. Përfaqëson Odën dhe vepron në emër të saj;
2. Fton dhe udhëheq seancat e Kuvendit
3. Kryetari i OFTK-së është edhe anëtarë i Këshillit Drejtues të OFTK-së
4. Ushtron të gjitha kompetencat, të cilat nuk i jepen në mënyrë eksplicite Kuvendit të Odës;
5. Ekzekuton aktet e Kuvendit të Odës;
6. Propozon Kuvendit të Odës emërimin apo shkarkimin e zv. kryetarëve të Odës.
7. Organizon punën dhe drejton politikën e odës;
8. Propozon rregullore apo akte të tjera për miratim në Kuvendin e Odës;
9. Raporton para Kuvendit të Odës për situatën ekonomiko-financiare të odës, së paku një herë në vit apo kurdoherë që kërkohet nga Kuvendi i Odës;
10. Kryen aktivitetet tjera që i caktohen me statut;
11. Në rast të mungesës Kryetarin e zëvendëson njëri nga zv. Kryetarët e Odës.

Neni 27

Kryetarin e Odës e zgjedh Kuvendi i Odës në pajtim me Rregulloren mbi Zgjedhjen e Organeve të OFTK-së.

Neni 28

1. Kuvendi i Odës mund të shkarkoj Kryetarin e Odës në këto raste:
 - 1.1. Shkel Statutin e OFTK-së,
 - 1.2. Vepron në kundërshtim me vendimet e ligjshme të Kuvendit,
 - 1.3. Dënohet me vendim përfundimtar për shkelje etike me organet etike të Odës,
 - 1.4. Dënohet me aktgjykim të formës së prerë për keqpërdorim të detyrës zyrtare apo veprat penale kundër shëndetit publik

Neni 29

1. Shkarkimi i Kryetarit të Odës realizohet sipas procedurës:
 - 1.1. Propozim i 1/3 të anëtarëve të Kuvendit të Odës,





Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës/ Komora Fizioterapeuta Kosova

Kosovo Chamber of Physiotherapists

- 1.2. Kërkesës për thirrjen e Kuvendit të Odës për shkarkimin e Kryetarit i bashkangjitet dokumenti i cili dëshmon përmbushjen e kriterëve nga paragrafi i I-rë,
- 1.3. Kuvendi i Odës thirret sipas procedurave të përcaktuara në Statut dhe Rregullore të Odës.
- 1.4. Kërkesa për shkarkim konsiderohet e miratuar nëse për të votohen nga 2/3 e anëtarëve të Kuvendit të Odës,
- 1.5. Në rast se Kuvendi dështon të miratoj shkarkimin e Kryetarit të Odës, kërkesa tjetër për shkarkim mund të paraqitet pas 90 (nëntëdhjetë) ditëve të ardhshme.

Neni 30

Propozimi për shkarkimin e Zv. Kryetarit/es të Odës mund ta bëjë vetëm Kryetari i Odës dhe një propozim i tillë konsiderohet i miratuar nëse për të kanë votuar shumica e anëtarëve të pranishëm të Kuvendit të Odës.

Neni 31

Kryetari i Odës, Zëvendës Kryetarët, nuk mund të jenë persona të zgjedhur dhe të emëruar në funksione tjera publike dhe politike, përveç profesionale mjekësore dhe në mësimdhënie.

Neni 32

Këshilli Drejtues

1. Këshilli Drejtues është organ i Odës i përbërë nga 11 anëtarë që ushtron përgjegjësi dhe kompetencat të parapara me Ligj, këtë Statut dhe aktet e tjera normative të Odës.

2. Këshilli Drejtues i Odës:

- 2.1. Është përgjegjës për zbatimin e vendimeve të odës;
- 2.2. Propozon plotësim ndryshimin e statutit dhe akteve tjera të odës;
- 2.3. Propozon Kuvendit anëtarët e organeve të Odës;
- 2.4. Përcjell dhe harmonizon punën e organeve të Odës;
- 2.5. Përcakton propozimin e programit të punës të odës;
- 2.6. Propozon organeve shtetërore masat për mbrojtjen dhe përparimin e mbrojtjes shëndetësore dhe sigurimit shëndetësor;
- 2.7. Propozon planin financiar të Odës dhe kujdeset për zbatimin e tij
- 2.8. Miraton llogaritë periodike financiare;
- 2.9. Emëron dhe shkarkon sekretarin e përgjithshëm të odës;
- 2.10. Shqyrton dhe miraton raportet periodike të punës së odave në fushat për të cilat është përgjegjëse;
- 2.11. Miraton rregulloren mbi organizimin dhe sistematizimin e punëve të shërbimit profesional të odës dhe merr masa për sigurimin e ligjshmërisë dhe efikasitetin e punës të shërbimit profesional;

Adresa: Kompleksi i Q.K.U.K, Klinika e Mjekësisë Fizikale me Rehabilitim, Kati i I-rë, RKS-10000.

Address: UCCK Complex, Physical Medicine Clinic with Rehabilitation, 1st Floor, RKS-10000.

Tel +383(0) 45 460 551; e-mail info@oftk-ks.org; web : www.oftk-ks.org

Oda e
Fizioterapeutëve
të Kosovës





Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës/ Komora Fizioterapeuta Kosova

Kosovo Chamber of Physiotherapists

- 2.12. Vendos në shkallë të dytë sipas ankesave nga marrëdhënia e punës të punëtorëve të shërbimit profesional të odës;
- 2.13. Inicion dhe njofton organet kompetente për shkeljen e konstatuar në fushën e fizioterapisë sipas akteve ligjore dhe nënligjore të Odës.
- 2.14. Inicion dhe njofton organet kompetente për shkeljet e supozuara në fushën e fizioterapisë për personat anëtarë ose jo anëtarë të odës.
- 2.15. Kryen dhe punë tjera të parapara me Statut të Odës.

Neni 33

1. Këshilli Drejtues i OFTK-së ka njëmbëdhjetë (11) anëtarë, nga të cilët një (1) anëtarë i komunitetit jo shumicë dhe një (1) anëtarë nga radhët e komuniteteve tjera.
2. Kryetari dhe zv. kryetarët e Odës janë anëtarë të Këshillit Drejtues sipas detyrës zyrtare.
3. Pesë (5) anëtarë të Këshillit Drejtues i zgjedh Kuvendi i Odës nga radha e anëtarëve të vetë, ndërsa tre (3) anëtarë të Këshillit Drejtues i delegon Ministria e Shëndetësisë.
4. Anëtarët e Këshillit Drejtues i zgjedh Kuvendi i Odës në pajtim me Rregulloren për Zgjedhjen e Organeve të OFTK-së.
5. Këshilli Drejtues i OFTK-së zgjedh Kryetarin dhe Zv. Kryetarin e Këshillit Drejtues të cilët propozohen nga Kryetari i OFTK-së dhe miratohen nga anëtarët e Këshillit Drejtues.
6. Kryetarin dhe Zv. Kryetarin e Këshillit Drejtues zgjidhen nga përbërja e Këshillit Drejtues, të zgjedhur nga Kuvendi i OFTK-së.
7. Mandati i anëtarëve të Këshillit Drejtues zgjat 4 vite dhe përputhet me mandatin e anëtarëve të Kuvendit.
8. Sekretari i Përgjithshëm i Odës është person i ftuar gjithmonë në takimet e Këshillit Drejtues të Odës.
9. Sekretari i Përgjithshëm i Odës nuk ka të drejtë vote por ka të drejtë për të propozuar pika në rendin e ditës dhe dokumentet mbështetëse të tyre.

Neni 34

1. Këshilli Drejtues merr vendime me shumicë të thjeshtë të anëtarëve prezent, nëse plotësohet kriteri i kuorumit të pjesëmarrjes 50+1 të anëtarëve të Këshillit Drejtues Mandati i anëtarëve të Këshillit Drejtues zgjat katër vite dhe përputhet me mandatin e anëtarëve të Kuvendit.
2. Mbledhjet e Këshillit Drejtues i udhëheq Kryetari i Këshillit Drejtues, në mungesë të Kryetarit, mbledhjet i udhëheq nënkryetari i Këshillit Drejtues të OFTK-së. Kryetari i Këshillit Drejtues së bashku me Kryetarin e Odës propozon rendin e ditës për mbledhjet e Këshillit Drejtues, të drejtë propozimi për pikat e rendit të ditës kanë edhe anëtarët e tjerë të Këshillit Drejtues të OFTK-së.
3. Pikat e rendit të ditës të propozuara duhet të miratohen nga anëtarët e KD.
4. Këshilli Drejtues mban mbledhje të rregullta së paku një here në muaj.





Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës/ Komora Fizioterapeuta Kosova

Kosovo Chamber of Physiotherapists

5. Mënyra e punës së Këshillit Drejtues përcaktohet me Rregullore të punës së Këshillit Drejtues të OFTK-së. Mënyra e punës së Këshillit Drejtues përcaktohet me akt të veçantë,
6. Këshilli Drejtues paraqet raport me shkrim Kuvendit për punën e tij së paku dy herë në vit.

Neni 35

Revokimi i anëtarëve të Këshillit Drejtues

1. Procedura mbi revokimin e anëtarëve të Këshillit Drejtues mund të fillohet me kërkesën e Kryetarit të Odës, Këshilli Drejtues (1/2 të anëtarëve), apo me iniciativën e 1/3 të anëtarëve të Kuvendit të Odës, nën arsyetimin për mos efikasitet apo pengim të punës efikase të Këshillit Drejtues. Së bashku me propozimin për revokim paraqiten edhe faktet dhe dëshmitë mbi të cilat bazohet kërkesa.
2. Konsiderohet se anëtari i Këshillit Drejtues të Odës janë të revokuar nëse për këtë kanë votuar shumica e anëtarëve të Kuvendit të Odës. Procedura e zëvendësimit të këtyre anëtarëve përcaktohet me Rregulloren për Zgjedhjen e Organeve të OFTK-së.

Neni 36

Këshilli Mbikëqyrës

Këshilli Mbikëqyrës i Odës:

1. Mbikëqyr dhe përcjellë afarizmin financiar të Odës;
2. Përcjellë dhe mbikëqyr realizimin e të drejtave dhe obligimeve të anëtarëve të Odës;
3. Mbikëqyrë dhe përcjell punën e shërbimit profesional të Odës;
4. Mbikëqyrë dhe përcjellë punën e Komisioneve të Odës;
5. Propozon Këshillit Drejtues marrjen e masave dhe veprimeve në rastet kur vlerëson ka shkelje ligjore të akteve të miratuara nga Kuvendi i Odës;
6. Kryen dhe punë tjera të parapara me Statut dhe me akte tjera të Odës.

Neni 37

1. Këshillin Mbikëqyrës të Odës e përbëjnë 7 anëtarë.
2. Kryetarin, zv. Kryetarin dhe tre 3 (tre) anëtarët e tjerë të Këshillit i zgjedh Kuvendi nga radha e anëtarëve të vetë, në pajtim me Rregulloren për Zgjedhjen e Organeve të OFTK-së, ndërsa dy (2) anëtarë i delegon Ministria e Shëndetësisë.





Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës/ Komora Fizioterapeuta Kosova

Kosovo Chamber of Physiotherapists

3. Kryetar i Këshillit Mbikëqyrës zgjedhet kandidati që ka fituar më së shumt vota nga të gjithë kandidatët e tjerë në zgjedhjet e Kuvendit të Odës për Këshill Mbikëqyrës, Kandidati i dytë për nga numri i votave zgjedhët zëvendës Kryetari i Këshillit Mbikëqyrës.

4. Këshilli Mbikëqyrës i OFTK-së për punën e vet i përgjigjet Kuvendit të Odës.

Neni 38

1. Procedura mbi revokimin e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës mund të fillohet me kërkesën e Kryetarit të Odës, Këshillit Mbikëqyrës (1/2 anëtarë), apo me iniciativën e 1/3 të anëtarëve të Kuvendit të Odës, nën arsyetimin për mos efikasitet apo pengim të punës efikase të Këshillit Drejtues. Së bashku me propozimin për revokim paraqitet edhe faktet dhe dëshmitë mbi të cilat bazohet kërkesa.
2. Konsiderohet se anëtari i Këshillit Mbikëqyrës i është revokuar mandati nëse për të revokimin e tij kanë votuar shumica e anëtarëve të Kuvendit të Odës. Procedura e zëvendësimit të anëtarit/es përcaktohet sipas Rregullores për Zgjedhjen e Organeve të OFTK-së.

Neni 39 Këshilli Etik

1. Mbikëqyr zbatimin e Kodit të Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore;
2. Siguron udhëheqjen etiko-morale e deontologjike dhe promovon principet dhe parimet e etikes profesionale;
3. Merr masat e duhura në rast të shkeljes së Kodit Etik dhe të deontologjisë mjekësore;
4. Pranon dhe shqyrton ankesat nga ana e qytetarëve;
5. Jep mendimet dhe vlerësimet për punën e anëtarëve të odës në pajtim me kodin e etikes profesionale;
6. I ofron mbështetje qytetarëve në realizimin e të drejtës së cilësisë së shërbimeve, lojit dhe përmbajtjes së shërbimeve;
7. Kryen dhe punë tjera ë parapara me statut të odës si dhe me akte të veçanta të odës;
8. Këshilli Etik ka pesë anëtarë;
9. Kryetarin dhe 4 anëtarët e tjerë të Këshillit Etik i zgjedh Kuvendi i Odës nga radha e anëtarëve të Odës, në pajtim me rregulloren mbi procedurën e kandidimit dhe mënyrën e zgjedhjes dhe revokimit të anëtarëve të odës dhe organeve të tjera.





Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës/ Komora Fizioterapeuta Kosova

Kosovo Chamber of Physiotherapists

Neni 40

1. Procedura e revokimit të anëtarëve të Këshillit Etik të Odës mund të fillohet me kërkesën e Kryetarit të Odës, Këshillin Etik (1/2 e anëtarëve), apo me iniciativën e 1/3 të anëtarëve të Kuvendit të Odës. Nën arsyetimin për mos efikasitet apo pengim të punës efikase të Këshillit Etik. Së bashku me propozim për revokim paraqiten edhe faktet dhe dëshmitë mbi të cilat bazohet kërkesa.
2. Konsiderohet se anëtarit të Këshillit Etik të Odës i është revokuar mandati nëse për revokimin e tij/saj kanë votuar shumica e anëtarëve të Kuvendit të Odës. Procedura e zëvendësimit të këtyre anëtarëve përcaktohet me Rregulloren për Zgjedhjen e Organeve të OFTK-së

Neni 41

Masat Disiplinore

Këshilli Etik është organ i shkallës së parë i cili fillon procedurën për përcaktimin e përgjegjësisë së profesionistëve shëndetësor për shkelje të ligjit mbi Odat e Profesionistëve Shëndetësor, Statutit të Odës dhe Kodit të Etikës mjekësore dhe varësisht nga shkeljet e konstatuara shqipton këto masa disiplinore:

1. Rekomandim kolegial;
2. Kërkim falje ndaj pacientit;
3. Qortim ose qortim publik;
4. Arsimim shtesë dhe të detyrueshëm pasuniversitar dhe trajnim;
5. Trajtimi i detyrueshëm nga alkooli, droga dhe vese të tjera;
6. Tërheqja e përkohshme ose e përhershme e licencës dhe/ose fshirja e profesionistit shëndetësor nga regjistri;
7. Kompensimin e dëmit të pacientit kur është e përshtatshme;
8. Dënimi me të holla deri në 1.000.00 – 3.000.00 EURO për çdo shkelje të ligjit, detyrave profesionale dhe etike;

Neni 42

1. Në procedurë para Këshillit Etik të Odës zbatohen dispozitat dhe rregullat e procedurës së përgjithshme administrative të ligjit mbi procedurë penale, mbi sigurimin e provave, procesverbalin, dëgjimin e palës dhe procedurave tjera në përputhshmëri me aktet e tjera të brendshme të OFTK-së
2. Anëtarit i Odës ndaj të cili i është filluar procedura disiplinore doemos duhet ti mundësohet deklarimi dhe mbrojtja para Këshillit Etik.
3. Në procedurën e marrjes në pyetje të anëtarëve të Odës dhe vlerësimit të provave në procedurë disiplinore para Këshillit Etik mbahet procesverbali.





Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës / Komora Fizioterapeuta Kosova

Kosovo Chamber of Physiotherapists

4. Sipas ankesës ndaj vendimit të Këshillit Etik vendos Gjykata e Nderit.

Neni 43

Fillimi i procedurës para Gjyqit të Nderit për përcaktimin e shkeljeve të anëtarit të odës nga neni 41 pika 4,5,6,7,8 nuk mund të filloj pas skadimit të një viti nga dita e shkeljes profesionale dhe shkeljes së nderit të anëtarit të Odës.

Neni 44

Kriteret për përcaktimin e shkeljeve, procedurën për përcaktimin e përgjegjësive të profesionistëve shëndetësor për shkeljet e këtij statuti të odës dhe kodit të etikës mjekësore përcaktohen me akt të veçantë të odës.

Neni 45

Gjyqi i Nderit

1. Gjyqi i Nderit të Odës së Fizioterapeutëve të Kosovës është organ i Odës së Fizioterapeutëve që ushtron funksionet e përcaktuara me ligj, me këtë statut dhe aktet e tjera normative të Odës.

2. Gjyqi i Nderit ushtron funksionin e vet në mënyrë të pavarur dhe duke u bazuar në Ligjin mbi Odat e Profesionistëve Shëndetësorë, këtë statut dhe aktet e tjera normative të odës.

Neni 46

1. Procedura mbi revokimin e anëtarëve të Gjyqit të Nderit mund të fillohet me kërkesën e Kryetarit të Odës, Këshillit Gjyqit të Nderit (1/2 e anëtarëve), apo me iniciativën e 1/3 të anëtarëve të Kuvendit të Odës, nën arsyetimin për mos efikasitet apo pengim të punës efikase të Gjyqit të Nderit. Së bashku me propozimin për revokim paraqitet edhe faktet dhe dëshmitë mbi të cilat bazohet kërkesa.
2. Konsiderohet se anëtarët e Gjyqit të Nderit janë të revokuar nëse për këtë kanë votuar shumica e anëtarëve të Kuvendit të Odës. Procedura e zëvendësimit të këtyre anëtarëve përcaktohet me Rregulloren për Zgjedhjen e Organeve të OFTK-së.

Neni 47

Ndaj vendimit përfundimtar me të cilën është shqiptuar masa disiplinore nga neni 41 pika 4, 5, 6, 7 dhe 8 i këtij Statuti fizioterapeutët mund të ushtrojnë ankesë pranë Gjykatës së Nderit të Odës së Fizioterapeutëve.





Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës/ Komora Fizioterapeuta Kosova

Kosovo Chamber of Physiotherapists

Neni 48

Gjyqi i Nderit vendos edhe lidhur me ankesat e anëtarëve të odës dhe parregullsive në procesin e zgjedhjeve të organeve të odës.

Neni 49

1. Gjyqi i Nderit ka 5 anëtarë, kryetarin, zëvendës kryetarin dhe 3 (tre) anëtarë të zgjedhur nga Kuvendi i Odës, në pajtim me Rregulloren për Zgjedhjen e Organeve të OFTK-së.

1 anëtarë e propozon Këshilli Gjyqësor i Kosovës

Neni 50

Prokurori i Odës

Prokurori i Odës është organ i pavarur për iniciimin e procedurës ndaj anëtarëve të odës ndaj të cilëve ekziston dyshimi i bazuar se ka bërë shkelje të ligjit, statutit dhe kodit të etikës mjekësore.

Neni 51

1. Procedura mbi revokimin e Prokurorit dhe zv. Prokurorit mund të fillohet me kërkesën e Kryetarit të Odës, Këshillit Etik (1/2 e anëtarëve), apo me iniciativën e 1/3 të anëtarëve të Kuvendit të Odës, nën arsyetimin për mos efikasitet apo pengim të punës efikase të Prokurorit. Së bashku me propozimin për revokim paraqitet edhe faktet dhe dëshmitë mbi të cilat bazohet kërkesa.
2. Konsiderohet se prokurori është revokuar nëse për këtë kanë votuar shumica e anëtarëve të Kuvendit të Odës. Procedura e zëvendësimit të këtyre anëtarëve përcaktohet me Rregulloren për Zgjedhjen e Organeve të OFTK-së.

Neni 52

Rastet e shkeljes nga Neni 41 i këtij Statuti mund t'i denoncojnë: Oda e Fizioterapeutëve, Odat e tjera mjekësore, Ministria e Shëndetësisë, Shoqatat e Profesionistëve Shëndetësor, Shoqatat e Fizioterapeutëve, Institucionet Shëndetësore, Fondi i Sigurimeve Shëndetësore, Prokuroria Shtetërore, anëtarët e Odës dhe pala e dëmtuar.





Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës/ Komora Fizioterapeuta Kosova

Kosovo Chamber of Physiotherapists

Neni 53

1. Prokurorin dhe zëvendësin e tij e zgjedh Kuvendi i Odës nga radha e anëtarëve të odës, në pajtim me rregulloren mbi procedurën e kandidimit dhe mënyrën e zgjedhjes dhe revokimit të anëtarëve të odës dhe organeve të tjera.

Neni 54

Komisionet e përhershme të Odës

1. Oda e Fizioterapeutëve ka komisionet e përhershme dhe të përkohshme.

2. Anëtarët e komisioneve të kuvendeve të odës i zgjedh Kuvendi i Odës nga radha e anëtarëve të odës, në pajtim me rregulloren mbi procedurën e kandidimit dhe mënyrën e zgjedhjes dhe revokimit të anëtarëve të odës dhe organeve të tjera.

Neni 55

Komisionet e përhershme të odës janë:

1. Komisioni për anëtarësim, rianëtarësim, licencim dhe ri-licencim,
2. Komisioni për çështje etike;
3. Komisioni për edukim specialistik;
4. Komisioni për edukim të vazhdueshëm profesional;
5. Komisioni për buxhet dhe financa;
6. Komisioni i solidaritetit dhe ndihmës reciproke.
7. Komisioni për Provim të Ri-licencimit.

Neni 56

1. Komisionet e përhershme të Odës përbehen nga jo më pak se 3 dhe jo më shumë se 7 anëtarë nga radhët e të cilëve zgjidhet kryetari dhe zv. kryetari i Komisionit.

2. Anëtarët e komisioneve të përhershme të odës mund të jenë anëtarë vetëm të një komisioni të përhershëm,

3. Mbledhjet e komisioneve të përhershme i fton dhe udhëheq kryetari i komisionit.

4. Këshilli Drejtues e propozon përbërjen e anëtarëve (kryetarin, zv. kryetarin, anëtarët) të komisioneve të përhershme të Odës së Fizioterapeutëve të Kosovës, përbërja e komisioneve votohet në Kuvendin e Odës së Fizioterapeutëve.





Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës/ Komora Fizioterapeuta Kosova
Kosovo Chamber of Physiotherapists

5. Komisionet e përhershme së paku 2 herë në vit raportojnë për punën e tyre Këshillit Drejtues dhe Kuvendit të Odës.

Neni 57

Përbërja dhe fushëveprimi i komisionit nga Neni 56 i këtij Statuti përcaktohen me akte të veçanta normative.

Neni 58

Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës realizon të hyra vetanake nga:

1. Anëtarësia,
2. Kompensimi (taksës) për anëtarët e odës, taksën për licencim dhe ri-licencim si dhe lartësinë e taksës për lëshimin e certifikatave, vërtetimeve dhe dokumenteve tjera për të cilat Oda mban evidencë zyrtare.
3. Të hyrat nga masat disiplinore të Odës,
4. Të hyrat e përcaktuara me akte të veçanta të Odës,
5. Dhuratat dhe donacionet e tjera si dhe të hyrat në pajtim me ligjin.

Neni 59

1. Anëtarët e Odës kanë obligim që në mënyrë të rregullt të paguajnë anëtarësinë, kompensimin për regjistrim, licencim dhe shërbime tjera administrative në pajtim me ligjin dhe aktet e tjera normative të odës.
2. Në rast dështimi të përmbushjes së këtyre obligimeve organet e odës marrin masa disiplinore ndaj anëtarëve të saj.

Neni 60

1. Oda hap llogari të veçantë, menaxhon mjetet e dedikuara në fondin e solidaritetit dhe ndihmës reciproke të anëtarëve të odës.
2. Mjetet nga paragrafi 1 i këtij Neni mund të përdoren për ofrimin e ndihmës së drejtpërdrejtë të anëtarëve të odës, dhe të anëtarëve të familjes së tyre në rast të fatkeqësie, për sigurim të odës të bartësve të sigurimit të pasurisë të personave në rast të lëshimeve profesionale si dhe aftësimin e vazhdueshëm profesional të anëtarëve të odës në pajtim me këtë ligj dhe statutin dhe aktet e tjera të odës.

Neni 61

Mjetet nga donacionet dhe dhuratat nuk mund të shfrytëzohen për mbulimin e shpenzimeve të odës përveç në rastet shprehimisht janë të destinuara për këtë qëllim.





Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës/ Komora Fizioterapeuta Kosova

Kosovo Chamber of Physiotherapists

Neni 62

Me akt të veçantë të Odës do të përcaktohet lartësia e kompensimit (taksës) për anëtarët e odës, taksës për licencim dhe ri-licencim si dhe taksës për lëshimin e certifikatave, vërtetimeve dhe dokumenteve tjera për të cilat oda mbanë evidencë zyrtare;

V. TRANSPARENCA E PUNËS SË ODËS

Neni 63

1. Oda e Fizioterapeutëve obligohet që të njoftojnë opinionin mbi çështjet e rëndësishme nga fushëveprimi i odës.
2. Oda ka për obligim të njoftojnë organet kompetente të ndjekjes, organet kompetente të gjyqësisë dhe Ministrinë e Shëndetësisë për procedurë disiplinore që udhëhiqet ndaj anëtarëve të odës nga organet e odës si dhe procedurën e licencimit, ri-licencimit dhe revokimit të licencës nëse dyshohet se në këto procedura ekziston dyshimi i bazuar që është kryer vepër penale.
3. Oda ka për obligim që me kërkesë të organeve nga paragrafi 2 i këtij neni t'i vejë në disponim të gjitha faktet dhe informatat që posedon.

Neni 64

Oda bashkëpunon me institucionet arsimore të profilit shëndetësor, institucionet shëndetësore, shoqatat e profesionistëve shëndetësor, fondet e sigurimeve shëndetësore lidhur me çështjet e rëndësishme për punët e odës dhe të mbrojtjes shëndetësore të qytetarëve.

Neni 65

1. Mbledhjet e Kuvendit dhe organeve tjera të odës janë të hapura për opinion.
2. Kuvendi i Odës apo organi tjetër i odës mund të vendos për përjashtimin e opinionit nga i tërë takimi apo nga një pjesë e tij në rastet kur takimi i hapur kërcënon të zbuloj informacione të cilat janë të klasifikuara si të besueshme sipas Ligjit mbi qasjen në dokumente zyrtare, si dhe informacione të ndjeshme personale apo komerciale.
3. Njoftimet për takimin e Kuvendit bëhen publike.
4. Me rregulloren mbi punën e Kuvendit parashihet procedura e njoftimeve publike për takimet e Kuvendit dhe organeve tjera.





Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës/ Komora Fizioterapeuta Kosova

Kosovo Chamber of Physiotherapists

VI. MBIKËQYRJA E PUNËS SË ODËS

Neni 66

- 1.Mbikëqyrjen ndaj ligjshmërisë së punës së odës në ushtrimin e funksioneve publike nga Neni 9 i Ligjit mbi Odat e Profesionistëve Shëndetësor e bënë Ministria përgjegjëse për Shëndetësi.
- 2.Në ushtrimin e mbikëqyrjes nga pika 1 e këtij Neni Ministria e Shëndetësisë mund të kërkon nga organet e odës raport dhe informata për çështje të caktuara.
- 3.Oda është e obliguar që raportet dhe informatat nga pika 2 e këtij Neni ti ofroj Ministrisë përgjegjëse për Shëndetësi në afat prej 30 ditësh nga dita e kërkesës, ose të informoj për arsyet për të cilat nuk është e mundur të dërgoj brenda afatit të kërkuar.
- 4.Oda është e obliguar që gjerë në 31 Mars të vitit vijues të dërgojnë Ministrisë përgjegjëse për Shëndetësi raportin vjetor për vitin paraprak.

Neni 67

- 1.Për financimin e aktiviteteve dhe raportimet financiare të Odës duhet të zbatohen rregullat e afarizmit financiar dhe të kontabilitetit në përputhje me ligjet e Kosovës.
- 2.Oda i nënshtrohet auditimit të pavarur së paku një herë në vit.

VI. AKTET E PËRGJITHSHME TË ODËS

Neni 68

- 1.Aktet e përgjithshme të odës janë Statuti, Kodi Etik dhe Deontologjik i Fizioterapeutëve, rregulloret e ndryshme, udhëzimet dhe vendimet e tjera të organeve të odës.
2. Aktet e përgjithshme të odës duhet të jenë në pajtim me Kushtetutën, Ligjin dhe këtë Statut.
- 3.Iniciativën për nxjerrje dhe ndryshim të akteve të përgjithshme të odës mund ta marrin organet e odës dhe shoqatat profesionale mjekësore.
4. Miratimin e akteve të përgjithshme të odës duhet ti paraprijë debati publik, me komunitetin e fizioterapeutëve.





Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës/ Komora Fizioterapeuta Kosova

Kosovo Chamber of Physiotherapists

VII. SHËRBIMI PROFESIONAL I ODËS

Neni 69

1. Zyra Administrative ushtron veprimtaritë e mëposhtme:
 - 1.1. Ushtrimin e detyrave administrative dhe profesionale;
 - 1.2. Regjistrimin, licencimin dhe autorizimin e profesionistëve shëndetësor dhe bashkëpunëtorëve shëndetësor e që nuk janë anëtarë të odave;
 - 1.3. Mbajtjen e regjistrit të profesionistëve shëndetësor;
 - 1.4. Aktivitete të tjera që odat mund t'i delegojnë Zyrës Administrative;
 - 1.5. Ushtron edhe detyra tjera administrative nga Neni 9 dhe Neni 10 i Ligjit mbi Odat e Profesionistëve Shëndetësor.
2. Këto detyra duhet të kryhen në bazë të kontratës për shërbime ndërmjet Odës dhe Zyrës Administrative.

Neni 70

1. Organizimi dhe puna e zyrës administrative përcaktohet me akt të veçantë për organizimin dhe sistematizimin e punëve të miratuar nga Kuvendi i Odës.
2. Të punësuarit në zyrën administrative të odës i gëzojnë të gjitha të drejtat dhe obligimet të përcaktuara me Ligjin e Punës, këtë Statut dhe aktet e tjera të Odës.
3. Punën e zyrës administrative e udhëheq Sekretari i Përgjithshëm i Odës.
4. Sekretarin e Përgjithshëm të OFTK-së e zgjedh Këshilli Drejtues i OFTK-së në bazë të Konkursit.

Dispozitat shfuqizuese

Neni 71

Me hyrjen në fuqi të këtij Statuti shfuqizohet Statuti paraprak i OFTK-së nr.03 të datës 01.04.2016.

VIII. DISPOZITAT KALIMTARE

Neni 72

Hyrja në fuqi

Ky Statut hyn në fuqi 7 (shtatë) ditë pas nënshkrimit nga Ministri i Shëndetësisë dhe Kryetari të Odës së Fizioterapeutëve të Kosovës.

Prishtinë, 22.12.2023

Kryetar i OFTK-së
Ass.MSc. Feim Gashi PT

Ministër i Shëndetësisë
Dr. Arben Vitia

